

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
DENIT shpk  
(me ortak te vetem)**

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Në këtë statut,

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, FORMA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**

**Themelimi, Forma dhe Emertimi i Shoqërisë**

Sot, më datë 08.01.2024 une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "DENIT" sh.p.k.

Themeluesi i shoqërisë është:

**Aranit Abili**, i biri i Ramiz, i datelindjes 20.06.1984, banues ne Tirane, ne adresen Rruga "Tre Deshmoret", Nd. 14 Tirane, me Leternjoftim ID nr. personal I40620249M.

Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Shoqëria do të paraqitet me emrin "Denit" Sh.p.k. Ky emertim është i vetmi i shoqërisë dhe perdoret ne të gjitha regjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me të tretet apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqëria do të ketë vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen e percaktuar nga Ortaku i vetem i shoqërisë.

Akti i themelimit dhe Statuti janë ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe kanë karakter të detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk janë shprehimisht të parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.



## **Neni 2**

### **Objekti**

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në baze të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a) Tregtim me shumice e pakice e artikujve të ndryshëm;
- b) Import-eksport me shumice e pakice të mallrave industriale, ushqimore, bujqësore e blegtorale;
- c) Punime artistike, qendistari, rrobaqepesi, bizhuteri dhe tregtimin e tyre;
- d) Prodhim dhe Tregtim të të gjitha llojeve të çantave, ambalazheve prej letre, zarfe prej letre dhe makineri të gjitha llojet që prodhojnë çantat prej letre dhe zarfe prej letre për qendra tregtare dhe të gjitha dyqanet: Çanta letre për super market; Çanta letre për dyqanet e rrobave; Çanta letre për furrat e bukës; Çanta letre për farmacite; Çantat letre për fruta perime; Dhe të gjitha llojet e çantave prej letre dhe kartoni, etj.; Leter paketimi për ushqime; Leter ushqimore për fastfood; Qese letre për restaurante; Çanta letre ushqimore për supermarket; Leter për paketim buke; Ambalazh letre me logo të personalizuar; Zarf letre i personalizuar me logo biznesi; Qese letre me logo për produkte; Qese letre dhe kuti për pastičeri; Qese letre për farmaci; Paketim me leter pa logo, formate dhe ngjyra të ndryshme; Çanta letre të personalizuar;
- e) Prodhimin, përpunimin, tregtimin e produkteve bujqësore e blegtorale, nënprodukteve të tyre, krijimin e fermave bujqësore, fabrikave të përpunimit, tregtim me shumice dhe pakice të produkteve bujqësore e blegtorale, e nënprodukteve të tyre;
- f) Tregtim të plastmasit për sera për bujqësi; Tregtim spango për lidhjen e ballave të barit për bujqësi; Tregtim mushama për kamiona dhe mushama për tenda; Tregtim tenda parkimesh.
- g) Shërbime transporti mallrash, transport inertesh, shit blerje makinash, autoservis, lavazh, bar-kafe.
- h) Aktivitet në fushën e hoteleri turizmit, bar, restorant, transport udhëtarësh;
- i) Ndertime civile dhe industriale të të gjitha llojeve, asfaltim rrugësh, punime mirëmbajtjeje, sinjalistike etj. Restaurime ndertime civile, të të gjitha llojeve si objekte kulti, vepra arti, rruge, ura etj;
- j) Prodhim të materialeve inerte, materialeve të ndertimit, import-export, tregtim me shumice e pakice të materialeve të ndertimit, tregtim me pakice të karburanteve, tregtim me shumice dhe pakice të lubrifikanteve, etj;
- k) Prodhimin dhe tregtimin e materialeve të duraluminit, dyer, dritare etj.
- l) Marrja dhe dhënia me qira e makinerive dhe pajisjeve të të gjitha tipeve dhe llojeve.
- m) Import, eksport dhe tregtim me shumice apo pakice të të gjitha llojeve të mjeteve motorike duke përfshirë importin e autoveturave, kamioneve dhe transportierëve të tij; import, eksport, si dhe tregtimin me shumice apo pakice të pjeseve të këmbimit, aksesoreve,



- agregateve per te gjitha llojet e mjeteve motorike, duke perfshire pjeset e kembimit per te gjitha llojet e autoveturave, kamioneve dhe transportiereve te cdo lloji.
- n) Blerje, shitje, mbajtje, transferim, dhenie me qira, administrim i zakonshem dhe i jashtezakonshem i pasurive te paluajtshme te cdo lloji apo natyre;
  - o) Te kryeje operacionet tregtare dhe industriale, financiare, bankare, hipotekuese, ekonomike dhe ne lidhje me pasuri te paluajtshme; te kerkoje dhe marre cdo forme financimi nga Institutet Kredithenese, bankat, shoqerite dhe Individet, duke dhene garanci te pershtatshme reale dhe personale.
  - p) Kryerja e aktiviteteve tregtare te cfaredo natyre dhe lloji, promovimin dhe organizimin e konferencave, seminareve, panairove, trajnimeve ne pergjithesi;

### **Neni 3** **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë "Denit" sh.p.k. eshte me nje afat te pacaktuar.  
Ky afat mund te ndryshohet ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.  
Shoqeria mund te priset ne cdo moment me vendim te asamblese se ortakeve.

### **Neni 4** **Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga "Tre Deshmoret, Ndertesa nr. 14, Tirane  
Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon : [abili.aranit@gmail.com](mailto:abili.aranit@gmail.com), nr.  
tel: 0682078011.

Transferimi i selise se shoqerise ne nje vend tjetër behet me vendim te Ortakut te vetem te Shoqerise.

Shoqeria ka te drejte te operoje me zyra, filiale, dege apo agjensi ne te gjithe territorin e Shqiperise apo dhe jashte vendit.

## **KREU II** **KAPITALI**

### **Neni 5** **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku i vetem themelues **Aranit Abili** me Leternjoftim ID nr. personal I40620249M.

: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Kontributi i ortakut te vetem mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

#### **Neni 6**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërise.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;



- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Te gjitha vendimet e e ortakeve regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

#### **Neni 9**

##### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

##### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me miratimin e ortakut te vetem.

#### **Neni 11**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me miratimin e maxhorances se cilesuar, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.



Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 12**

#### **Përfshirja nga e drejta e votës**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori dhe ortaku i vetem:

**Aranit Abili**, i biri i Ramiz, i datelindjes 20.06.1984, banues në Tiranë, në adresën Rruga "Tre Deshmoret", Nd. 14 Tiranë, me Leternjoftim ID nr. personal I40620249M.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:



- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të therase Asambletë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;



- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit, kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## KREU IV VITI FINANCIAR - EKSPERTET

### Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

 8

### **Neni 17**

#### **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **KREU V**

#### **PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 18**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Ortakeve.

### **Neni 19**

#### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË "DENIT" SH.P.K.**

**Aranit Abili**

Aranit Abili  
